



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2324, datë 28.06.2013

Për
“Miratimin e Dokumentit "Statusi Aktual dhe Plani Kuadër 2013-2016 për Shërbimin Universal në Shqipëri””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Znj. Alketa	Mukavelati	Kryetare
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Znj. Elkeda	Domi	Anëtare
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj.Mirela Xhelaj, në mbledhjen e datës 28.06.2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e Dokumentit "Statusi Aktual dhe Plani Kuadër 2013-2016 për Shërbimin Universal në Shqipëri””

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 25 e në vijim të Kreut V, si dhe nenet 110, 114 dhe 115 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (**ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**ligji nr. 8485**), i ndryshuar;
3. Udhëzues për Procedurat e Keshillimit me Publikun miratuar me VKD nr.1183, datë 10.03.2010.
4. VKD Nr.2180, datë 29.10.2012, Për “*Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Detyrimi i Shërbimit Universal- Dokument Konsultimi Publik*”

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N:

1. Dokumentacioni i paraqitur nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhërin nr. 705, datë 07.06.2011, përbëhet nga:
 - a. Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485;
 - b. Dokumenti "*Statusi Aktual dhe Plani Kuadër 2013-2016 për Shërbimin Universal në Shqipëri*"
 - c. Dokumenti: "*Detyrimi i Shërbimit Universal në Shqipëri-Raporti Final*", i përgatitur nga Konsulenti Nderkombëtar i përzgjedhur nga Banka Botërore (BB) në kuadrin e asistencës së BB për AKEP për implementimin e shërbimit universal në Shqipëri;
 - d. Relacioni shpjegues për Projektvendimin e KD.
2. Gjatë vitit 2012 Banka Botërore (BB) ofroi asistencë në procesin e implementimit të Shërbimit Universal (SHU) në Shqipëri. Objektivi kryesor i projektit ishte ndihma për Shqipërinë në identifikimin e objektivave dhe zhvillimin e një kuadri të plotë për SHU. Për realizimin e projektit BB përzgjodhi konsulentin ndërkombëtar "Sepulveda Consulting" (në vijim Konsulenti).
3. Bashkëpunimi filloi në Mars 2012, me zhvillimin e takimeve të para të konsulentit dhe përfaqësuesit të BB për projektin me AKEP, MITIK si dhe me lojtarët kryesorë të tregut. Këto takime u pasuan me shkëmbime komentesh dhe informacionesh nga AKEP dhe MITIK mbi versionet e para të dokumentit të përgatitur nga Konsulenti si dhe me takimet e zhvilluara me lojtarët kryesorë të tregut në Shtator 2012 ku materiali draft iu prezantua operatoreve në formën e prezantimit. Në perfudim të ketyre proceseve, dhe pasi u morrën në konsideratë komentet dhe diskutimet me AKEP, MITIK dhe me lojtarët e tregut, konsulenti përgatiti dokumentin "*Detyrimi i shërbimit universal - Dokument konsultimi publik*", i cili u miratua nga AKEP me VKD nr.2180, datë 29.10.2012 për konsultim publik me palët e interesuara. Dokumenti u publikua në faqen e Internetit të AKEP për konsultim publik më 1.11.2012-1.12.2012.
4. Dokumenti për Konsultim Publik përmbante midis të tjerave:
 - panoramë të politikave, kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës të Bashkimit Europian dhe të Shqipërisë në lidhje me SHU, përfshirë amendimet e propozuara të ligjit 9918, të cilat u miratuan dhe hynë në fuqi më 1.12.2012;
 - përmbledhje të zhvillimeve kryesore të sektorit dhe situatën aktuale të sektorit në Shqipëri, në vendet e BE-së dhe rajonit si dhe disa të dhëna dhe analiza relevante në nivel rajonal për Shqipërinë;
 - përshkrim mbi mënyrën specifike në të cilën vendet e BE-se dhe rajonit kanë implementuar SHU në praktikë;
 - diskutim të detajuar të elementeve kryesore të çdo regjimi SHU dhe opsionet përkatëse;

- propozime për një sërë parimesh që do të udhëheqin hartimin dhe zbatimin e një plani kuadër shumë-vjeçare ("Plani Kuadër") si dhe propozime për hapat e mëtejshme për implementimin e SHU në Shqipëri.
5. Qëllimi i këtij konsultimi ishte që të merreshin komentet e palëve të interesuara për një sërë çështjesh të lidhura me implementimin e regjimit të shërbimit universal në Shqipëri. Në përfundim të këtij procesi konsultimi, AMC, Vodafone Albania, Albtelecom dhe Plus Communication dhanë komente mbi dokumentin e nxjerre ne konsultim publik dhe shumica e palëve të interesuara ishin dakort me mënyren e trajtimit dhe vlerësimit të statusit të elementëve të shërbimit uiniversal.
 6. AKEP në bashkëpunim me MITIK, Bankën Boterore dhe Konsulentin, më datë 20.12.2012, zhvilloi një seminar për Shërbimin Universal në Shqiperi me pjesemarrje të paleve të interesuara. Në seminar, Konsulenti prezantoi një përmbledhje të projektit, komenteve të operatoreve si dhe disa rekomandime paraprake për implementimin e Shërbimit Universal në Shqipëri. Ky dokument, që permban dhe komentet kryesore të operatorëve, gjendet i publikuar në faqen e Internetit të AKEP, në seksionin *Njoftime*.
 7. Konsulenti në fund të muajit Dhjetor 2012 ka dërguar në AKEP, Raportin Final mbi Detyrimin e Shërbimit Universal në Shqipëri. Raporti final i Konsulentit përmban një përmbledhje të projektit si edhe rekomandimet finale për parimet për implementimin e shërbimit universal, përcaktimet e elementëve të SHU, statusin aktual të tyre dhe veprimet për hapat e mëtejshme për implementimin e shërbimit universal në Shqipëri, të cilat janë dhënë më poshtë në mënyrë të përmbledhur.

I. Parimet kryesore për iplementimin e shërbimit universal:

- Së pari, Zgjidhjet e Tregut.
- Çdo ndërhyrje duhet të jetë në proporcion me kushtet kombëtare.
- Direktiva e SHU duhet të implementohet duke reflektuar statusin kombëtar të sektorit.
- Siguri ligjore dhe korrektësi procedurale.
- Analiza dhe planifikimi i ardhshëm.

II. Vleresimi i situates se elementeve te sherbimit universal

• Aksesi dhe sherbimet nga vendndodhje fikse

Zhvillimi i sektorit ne Shqiperi ka qene disi i ndryshem nga situata ne vendet e BE ne vitin 2002 kur KE miratoi direktiven e Sherbimit Universal. Ne keto vende niveli i penetrimit të telefonise fikse ka qene shume më i larte se niveli i atëhershëm dhe aktual i Shqiperisë. Duke pasur parasysh dendësinë celular / fikse dhe dinamikën e mbulimit, disa vende kanë vendosur që shërbimet fikse te ofruara nga rrjetet celulare plotësojnë kriteret për këtë element te sherbimit universal. Një shërbim i ngjashëm është aktualisht i diponueshem në Shqipëri (AMC Fiks) dhe AKEP ka arritur ne perfundimin se këto shërbime janë pjesë e tregjeve përkatëse me pakicë te aksesit / thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse. Një shërbim i tillë përdor një aparat telefonik fiks te pajisur me karte GSM dhe me numer gjeografik fiks dhe mund te perfitohet kudo ku ka mbulim GSM (99.8% e popullsisë). Rrjeti GSM i AMC në

kombinim me rrjetin e Albtelecom dhe Operatoreve te tjere fiks, mbulon rreth 99,8% të popullsisë. Në këndvështrimin e Konsulentit, ky mbulim popullsie tregon se ky element i shërbimit universal aktualisht është shumë afër disponueshmerise universale në Shqipëri. Bazuar në këtë vlerësim, Konsulenti konsideron se tregu aktualisht ploteson nevojat e perdoruesve fundore në lidhje me disponueshmërinë e këtij elementi të shërbimit universal. Më tej, analiza e kryer në dokumentin e konsultuar tregon se shërbimi telefonik fiks në përgjithësi, dhe shërbimi i Albtelecom dhe AMC Fix në mënyrë specifike, jane te disponueshme me çmime të përballueshme, per kushtet kombëtare në Shqipëri.

Ne kete menyre, Konsulenti konsideron se Shqipëria plotëson ne mase te konsiderueshme detyrimin e SHU që ky element "të jete i diponueshem për të gjithë përdoruesit kudo ne territorin e Shqiperise, me një çmim të përballueshem". Konsulenti rekomandon qe Shqiperia nuk ka nevojë të percaktoje këtë element të SHU duke përcaktuar ofrues të Shërbimit Universal. AKEP mund të koordinoje/inkurajojë një ose disa operatorë të ofrojnë akses në vendndodhje specifike që nuk kanë shërbim telefonik jashtë skemës së SHU. Konsulenti i rekomandon AKEP që të rishikojë statusin e këtij elementi në fund të vitit 2015.

- **Aksesi Broadband**

Konsulenti nuk rekomandon përfshirjen e aksesit broadband në këtë element (apo ndonjë tjetër) te SHU në këtë kohë. Analiza tregon se aksesi broadband fikse dhe celular po rriten me shpejtësi në Shqipëri - në fakt, tregu broadband nuk është ende i maturuar dhe një ndërhyrje me detyrime të SHU nuk do të ishte përshtatshme në dinamika të tilla te tregut, sepse kjo do të ishte shumë herët për të konkluduar që tregu nuk ka qenë në gjendje për të përmbushur nevojat e përdoruesve. Në të vërtetë, mbulimi me rrjet broadband (si fikse dhe celulare) janë më të gjera se niveli i penetrimit, duke treguar se disponueshmëria është më e madhe se të perqindja e personave qe kane aktualisht akses dhe se ndërhyrja me detyrim të SHU nuk do të ishte e përshtatshme edhe nga ky këndvështrim. Më tej, tregu broadband në Shqipëria nuk përmbush "Rregullin 50/80" te BE për përfshirjen e aksesit broadband në detyrimet e SHU. Më tej, siç është përcaktuar në dokumentin e konsultuar, kostoja e përfshirjes së broadband në detyrimet e SHU në Shqipëri do të ishte shume jashtë niveleve të rekomanduara nga KE dhe do të përbënte një barrë disproporcionale në sektorin e telekomunikacioneve te Shqipërisë. Në mënyrë të përmbledhur, promovimi i broadband nëpërmjet detyrimeve të SHU nuk është mekanizmi i përshtatshëm në këtë kohë. Konsulenti rekomandon që AKEP të shqyrtojë këtë çështje në Dhjetor 2015. Ndërkohë, në qoftë se Qeveria Shqiptare e konsideron të përshtatshme, ajo mund të dëshiroje te marre ne konsideratë mekanizma të tjerë per promovimin broadband, duke përfshirë ato të përcaktuara në Projekt Planin Kombëtar Broadband.

- **Numeratori telefonik dhe rubrika e informimit për numrat**

Aktualisht, Shqipëria nuk disponon numerator telefonik apo shërbim të kërkimit të informacionit në numerator. Albtelecom ofron informacion për numrat e pajtimtarëve të tij nëpërmjet numrit të shkurtër 124, nderkohe as Operatorët Alternativë dhe as operatorët

celularë nuk ofrojnë numerator apo shërbim për kërkimin e informacionit në numerator për pajtimtarët e tyre. Shqipëria aktualisht nuk e përmbush detyrimin e SHU për këtë element.

Duket se preferencat e konsumatorit në Shqipëri janë të tilla që shumë abonentë celular nuk dëshirojnë të përfshijne numrin e tyre celular ne numerator, per shkak te shqetesimeve mbi mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë. Për shembull, sipas operatoreve, shumica e klientëve me kontratë nuk zgjedhin opsionin për tu përfshirë në numerator. Bazuar në konsideratat e mësipërme, Konsulenti konsideron se ne mungese te ndërhyrjes rregullatore, nuk ka te ngjarë qe në tre vitet e ardhshme ky shërbim te ofrohet nga ana e tregut në Shqipëri, në një mënyrë që të përmbushë kriteret direktives se SHU.

Konsulenti konsideron kritike që secili prej operatorëve të fillojë procesin e ndërtimit të bazës së të dhënave përkatëse te tyre me qëllimin e arritjes se një zgjidhjeje te ardhshme nga tregu per kete element te SHU. Nderkohe AKEP mund te marre në konsideratë sigurimin e kuadrit rregullator për shkëmbimin e këtij lloj informacioni te lidhur me numeratorin midis operatoreve dhe palës qe ofron keto shërbime. Zbatimi i dispozitave të tilla rregullatore mund të krijojë kushtet e tregut për një palë të tretë ose per një nga operatorët për të kërkuar informacion nga të gjithë operatorët për të formuluar një numerator të plotë apo shërbime te kerkimit te informacionit ne numerator.

Konsulenti nuk rekomandon që Shqipëria të caktojë këtë element te SHU në këtë kohë, sepse tregu nuk ka qenë i pajisur me mundësi të përshtatshme për të përmbushur nevojat e përdoruesve. Në vend të kësaj, Konsulenti rekomandon që AKEP të ndërmarrë masa rregullatore për të lehtësuar dhe për të promovuar një zgjidhje të tregut për këto element te SHU. Konsulenti rekomandon që AKEP te rishikojë statusin e këtij elementi ne Dhjetor 2015.

- **Disponueshmëria telefonave Publike me Pagesë**

Densiteti i telefonave publike me pagese ka qenë në rënie në të gjithë BE dhe vendet e rajonit. Densiteti i telefonave publike me pagese ne Shqipëri është edhe më poshtë se nivelet mesatare ne BE dhe rajon. Rënia në densitetin e telefonave publike me pagese në të gjithë kontinentin pasqyron një trend botëror të gjerë që reflekton përdorimin dhe nevojën e reduktuar për telefonat publike me pagese për shkak të preferencave të konsumatorit per alternativa konkurruese, përfshirë mbulimin dhe aksesin global celular.

Për të pasqyruar këtë dinamike te tregut, disa vende të BE nuk e kanë përcaktuar disponueshmërinë e telefonave publike me pagese si një element te detyrimeve te SHU, per shkak te arritjes ne perfunimn se përfshirja e këtij elementi nuk është efiçente ose se kostot jane me te medha se përfitimet per shkak te përdorimit në rënie te tyre.

Konsulenti konsideron se është e mundshme që aktualisht tregu i plotëson ndjeshëm nevojat e përdoruesve për këtë element te SHU. Në këtë rast, nuk është e nevojshme për Shqipërinë që të caktojë këtë element te SHU. Megjithate edhe ne rast se tregu nuk po përmbush të gjitha nevojat e përdoruesve (rast pak i mundshem), Konsulenti perseri nuk rekomandon që ky element i SHU te percaktohet nga AKEP, pasi nje percaktim i tille nuk do te ishte proporcional per shkak te përdorimit dhe rëndësise ne renie të këtij elementi. Nëse është e

përshtatshme, AKEP mund të koordinojë/inkurajojë një ose më shumë operatorë që të ofrojnë telefona publike me pagese në vende të veçanta, por jashtë çdo skeme të detyrimeve të SHU. Konsulenti rekomandon që AKEP të rishikojë statusin e këtij elementi të detyrimeve të SHU në Dhjetor 2015.

- **Masat për përdoruesit me aftësi të kufizuar**

Aktualisht, Qeveria Shqiptare ofron një pagesë mujore prej 1000 lekë për përdoruesit me aftësi të kufizuara për të ndihmuar në financimin e pagesës së shërbimeve të telekomunikacionit. Bazuar në paketa të veçanta që janë vënë në dispozicion nga Albtelecom, një subvencion i tillë pagese nga Qeveria Shqiptare lejon që përdorues të tillë me aftësi të kufizuara të blejnë një paketë të kombinuar të telefonisë dhe broadband që përfshin përdorim në masë të konsiderueshme të ketyre shërbimeve. Gjithashtu, disa operatorë fikse dhe mobile ofrojnë masa/pajisje dhe skonto specifike për përdoruesit me aftësi të kufizuara, në baza komerciale dhe si pjesë e aktiviteteve të bazuara në komunitet. Të dyja këto iniciativa të QSH dhe sektorit privat janë të disponueshme në të gjithë territorin kombëtar.

Per sa me sipër Konsulenti rekomandon që nuk do të jetë e nevojshme për Shqipërinë që të përcaktojë këtë element të detyrimeve të SHU. AKEP mund të koordinojë/inkurajojë një ose më shumë operatorë për të siguruar masa specifike jashtë çdo skeme të detyrimeve të SHU. Konsulenti rekomandon që AKEP të rishikojë statusin e këtij elementi të detyrimeve të SHU në Dhjetor 2015.

III. Plani Kuader për SHU

Konsulenti në përfundim të analizave të kryera ka dhënë disa rekomandime për hapat e mëtejshme për SHU në Shqipëri, duke i ndarë në tre faza, periudhe afatshkurter, afatmesme dhe afatgjate.

Periudhe Afat shkurtër (0-12 muaj)

- i. Nuk është e nevojshme që të përcaktohet ndonjë element i detyrimeve të SHU ose ofruesi i SHU. Prandaj, nuk është e nevojshme të miratohen masa të tjera të lidhura me SHU (p.sh. kërkesa për kompensim; mekanizmi i financimit sektorial nëpërmjet mbledhjes së kontributeve operatorit (fondi i SHU), etj).
- ii. Për të përmbushur pritshmeritë e tregut në lidhje me përfundimet e konsultimit publik të kryer në Nentor 2012, mund të shërbejë dokumenti i publikuar nga AKEP në faqen e Internetit për Seminarin e zhvilluar më 20 Dhjetor, 2012. Për të formalizuar konkluzionet në lidhje me përcaktimet e Detyrimeve të SHU, AKEP nëse e konsideron të përshtatshme mund të nxjerrë vendime përkatëse.
- iii. Të hartohen dhe përgatiten për konsultim publik masat rregullatore për të promovuar zgjidhjet nga ana e tregut për numërorin telefonik dhe shërbimet e kerkimit të

informacionit per numrat, duke përfshirë krijimin e bazeve se të dhenave të secilit operator për pajtimatret e vet dhe për akses dhe shkëmbim të këtij informacioni me palë të treta.

iv. Të hartohen dhe përgatiten për konsultim publik Rregulloret dhe aktet e tjera nen-ligjore të SHU të referura në Ligjin 9918, i amenduar, për të plotësuar dispozitat përkatëse të Ligjit, si mënyrë për të siguruar më shumë detaje dhe specifikime, duke përfshirë në lidhje me kriteret, procedurat dhe metodologjinë, çështjet administrative.

Ne periudhe Afatmesme (13-24 muaj)

v. Nëse është e nevojshme, AKEP të ndërmarrë një studim dhe analizë më të detajuar të masave për akses ekuivalent për përdoruesit me aftësi të kufizuara.

Ne periudhe Afat-gjatë (25-36 muaj)

vi. Rishikimi i statusit të detyrimeve dhe përcaktimeve të SHU të kryhet pas 3 viteve.

8. AKEP gjykon se analiza dhe rekomandimet e konsulentit reflektojnë në mënyrë objektive situatën aktuale dhe të pritshme të tregut në Shqipëri dhe Grupi i Punës i ngritur me Urdhërin nr. 705, datë 07.06.2011, ka përgatitur dokumentin “*Statusi Aktual dhe Plani Kuadër 2013-2016 për Shërbimin Universal në Shqipëri*“, i cili bazohet në përfundimet dhe rekomandimet e Konsulentit të dhëna në raportin Final të tij.
9. Dokumenti “*Statusi Aktual dhe Plani Kuadër 2013-2016 për Shërbimin Universal në Shqipëri*“, përmban përfundimet për vlerësimin e statusit aktual të SHU dhe Planin Kuadër 2013-2016 për SHU në Shqipëri.
10. AKEP nuk ka përcaktuar ndonjë element apo ofrues të SHU si edhe as nuk ka bërë ndonjë përcaktim se të gjithë elementet e SHU janë duke u siguruar në mënyrë adekuate në kushtet e tregut. Në këtë kontekst, AKEP gjykon që nëpërmjet këtij vendimi të miratojë përfundimet e arritura nga analiza e kryer për statusin aktual të elementëve të SHU si dhe të miratojë Planin Kuadër 2013-2016 për SHU, i cili përmban veprimet e mëtejshme për përmbushjen e detyrimeve të SHU.
11. AKEP vlerëson se miratimi i dokumentit “*Statusi Aktual dhe Plani Kuadër 2013-2016 për Shërbimin Universal në Shqipëri*” i shërben realizimit të objektivave rregullatore për implementimin e shërbimit universal në Shqipëri si dhe i shërben palëve të interesuara për t’u njohur me veprimet e mëtejshme të AKEP për SHU në Shqipëri.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e implementimit të shërbimit universal në Shqipëri, bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të miratojë dokumentin "*Statusi Aktual dhe Plani Kuadër 2013-2016 për Shërbimin Universal në Shqipëri*", bashkangjitur këtij vendimi.
2. Të vijojë puna bazuar në rezultatet e miratuara të këtij dokumenti për paraqitjen e propozimeve lidhur me aktet që duhet të nxjerri AKEP-i për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9918 për zbatimin e Shërbimit Universal.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R E

Alketa MUKAVELATI

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI
2. Benon PALOKA
3. Elkeda DOMI
4. Zamira NURCE



AUTORITETI KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Statusi Aktual dhe Plani Kuadër 2013-2016 për Shërbimin Universal në Shqipëri

Qershor 2013

Miratuar me VKD nr. __date __. __2013



AUTORITETI KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**Statusi Aktual dhe Plani Kuadër
2013-2016 për Shërbimin Universal
në Shqipëri**

Qershor 2013

Miratuar me VKD nr. __date__. __2013

Përmbajtja

1	Hyrje	2
2	Parimet për SHU	3
3	Vlerësimi i Elementëve të detyrimit të SHU	4
3.1	Aksesi dhe Shërbimi Telefonik nga Vendndodhje Fikse	4
3.2	Disponueshmëria e Numeratorit Telefonik dhe Rubrika e Informimit për Numrat	5
3.3	Disponibiliteti i Telefonave Publikë me Pagesë	6
3.4	Masat ekuivalente për përdoruesit me aftësi të kufizuar	6
4	Plani Kuadër 2013-2016 për SHU	8

Lista e Shkurtimeve

AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Europian
BE (EU)-12	12 Vendet Anëtare të BE që u pranuan në 2004 dhe më vonë
BE (EU)-15	15 Vendet Anëtare të BE që janë pranuar para 2004
CDir	Numerator Telefonik i Përgjithshëm
CPC	9 vendet Kandidate dhe Kandidatë të Mundshëm për hyrje në BE
DES	Shërbimet e Kërkimit në Numerator
DSHU	Direktiva e Shërbimit Universal
FGSM	GSM Fiks
FNT	Fuqi e Ndjeshme në Treg
FSHU	Fondi i Shërbimit Universal
KE	Komisioni Europian
KM	Këshilli i Ministrave
MITIK	Ministria për Inovacion dhe Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit
OSHU	Ofrues i Shërbimit Universal
PKE	Politika për Komunikimet Elektronike
SHU	Shërbimi Universal
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
VA	Vendet Anëtare të Bashkimit Europian

1 Hyrje

Politika e Qeverisë Shqiptare për Komunikimet Elektronike (PKE) e vitit 2010 përcakton strategjinë afatmesme të Qeverisë për zhvillimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike. PKE vijon nga Strategjia Kombëtare për të gjithë ekonominë e Qeverisë Shqiptare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013 ("SKZHI") dhe kërkon të arrijë integrimin në tregun e përbashkët të BE-së për komunikime elektronike.

Në këtë kontekst, Ligji 9918 ka hyrë në fuqi në vitin 2008 me objektivin për të transpozuar *acquis communautaire* të BE-së në këtë drejtim dhe veçanërisht të kuadrit rregullator të vitit 2002 për sektorin e komunikimeve elektronike. Ndryshimet në ligjin 9918 hynë në fuqi më 1 Dhjetor 2012 me objektivin për të transpozuar dispozitat përkatëse të *acquis communautaire* (në këtë rast kuadri rregullator i përditësuar i 2009).

Kuadri rregullator i BE-së në lidhje me shërbimin universal është përfshirë në DSHU, e cila fillimisht doli në vitin 2002 dhe u rinovua në vitin 2009. Kapitulli V i Ligjit 9918 (i ndryshuar) përfshin dispozita të shërbimit universal dhe është hartuar që përgjithësisht të tranzpozohet shumicën e dispozitave kryesore të DSHU (versionin origjinal të 2002 dhe ndryshimet e 2009).

Megjithatë, miratimi i kuadrit rregullator të BE për këtë fushë, është një hap i parë drejt plotësimit të kërkesave të integritit në BE, të cilat mandatojnë edhe implementimin dhe zbatimin e *acquis communautaire*. Për shembull, DSHU vendos një detyrim për VA (Vendet Anetare) për të siguruar që elementet e SHU "të jenë të disponueshme në cilësinë e specifikuar për të gjithë përdoruesit fundorë në territorin e tyre, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike ...me një çmim të përballueshëm". DSHU përcakton se VA duhet që së pari të mbështeten në rezultatet e tregut për të arritur këto detyrime, dhe të përfshijnë një ose më shumë përcaktime rregullatore të SHU vetëm nëse tregu nuk është duke i plotësuar nevojat e përdoruesve.

Ky dokument përmban një përmbledhje të parimeve që duhet të ndiqen nga AKEP për Shërbimin Universal, përfundimet e analizës së kryer për statusin aktual të SHU (sipas elementëve të vecantë) në Shqipëri si dhe Planin Kuadër të veprimeve të mëtejshme për periudhën 2013-2016. Dokumenti është bazuar në përfundimet e konsultimit publik të kryer për Shërbimin Universal në Nëntor 2012 si dhe rekomandimet e Konsulentit në Raportin Final të tij për AKEP.

2 Parimet për SHU

Seksioni 5.2 i dokumentit të konsultimit publik propozoi një sërë parimesh që do të përdoren në hartimin dhe zbatimin e Planit Kuadër të SHU. Këto parime janë përmbledhur më poshtë:

- **Së pari, Zgjidhjet e Tregut.** Kur është e mundur, mekanizmat e tregut duhet të jenë mënyra e preferuar e plotësimit të objektivave të shërbimit universal. Ndërhyrja rregullatore në formën e vendosjes së një regjimi të përcaktimit të detyrimit të SHU të bazuar në përputhje me DSHU, duhet të konsiderohet me kujdes bazuar në kushtet kombëtare dhe statusin e sektorit. Çdo ndërhyrje e tillë duhet të bazohet në një vlerësim që ka përfitime neto në krahasim me alternativën e zgjidhjeve të tregut.
- **Çdo ndërhyrje duhet të jetë në proporcion me kushtet kombëtare.** Parimi i proporcionalitetit është një faktor kyç në vlerësimin kosto/ përfitim për krijimin e një regjimi të SHU në përputhje me DSHU. Vendet Anëtare të BE që kanë pasur sukses në lidhje me kërkesën për kompensim ose në përdorimin e mekanizmave të financimit të shërbimit universal (FSHU) janë kryesisht vende me popullsi shumë më të madhe dhe me të ardhura më të larta se Shqipëria. Në këtë mënyrë AKEP gjykon përdorë një prag relativisht të lartë për caktimin e detyrimeve të SHU pasi këto mund të kërkojnë krijimin e një mekanizmi kompensimi.
- **DSHU duhet të implementohet duke reflektuar statusin kombëtar të sektorit.** Analiza e kryer në dokumentin e konsultimit publik tregon se ka një variacion të konsiderueshëm në mënyrat e implementimit të elementeve të SHU ndër Vendet Anëtare të BE dhe vendet e rajonit (CPC) dhe se variacioni i tillë duket së është i bazuar në kushtet kombëtare dhe arsye administrative. Në këtë aspekt, duke marrë parasysh kushtet kombëtare dhe konsideratat administrative vendet e BE-12 (të futura më vonë në BE) dhe rajonit SEE (CPC-9) mund të jenë relativisht më të krahasueshme me Shqipërinë. Në disa prej këtyre vendeve ku janë caktuar ofrues të Shërbimit Universal, (p.sh. Republika Çeke, Rumania dhe Mali i Zi) ato kanë vendosur që disa shërbime të ofruara nga vendndodhje fikse nëpërmjet rrjeteve celulare plotësojnë gjithashtu kriteret e elementit të SHU për akses dhe shërbim nga vendndodhje fikse.
- **Siguri ligjore dhe korrektësi procedurale.** Nga përvoja ndërkombëtare vihet re se zbatimi i DSHU ka qenë objekt i vonësive administrative dhe apelimeve gjyqësore në lidhje me përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal, llogaritjen e kostove neto të DSHU dhe pagesën në mekanizmin e kontributit të sektorit. AKEP gjykon që në përputhje me praktikën ndërkombëtare dhe rajonale, të përgatiten rregulloret që do të plotësojnë parashikimet e ligjit 9918, të ndryshuar, për shërbimin universal (rregulloret e Shërbimit Universal).
- **Analiza dhe planifikimi i ardhshëm.** Implementimi i plote i shërbimit universal do të jetë një proces shumë-vjeçar dhe në këtë kontekst, Plani Kuadër i shërbimit universal është përgatitur që bazuar në situatën e tanishme dhe në tendencat afatmesme, të përcaktojë veprimet e mëtejshme për SHU në një kohëzgjatje shumë-vjeçare 2013-2016.

3 Vlerësimi i Elementëve të detyrimit të SHU

Për çdo element të SHU të përfshirë në DSHU, ky seksion vlerëson nëse tregu aktualisht është duke përmbushur ose perspektivisht pritet të përmbushë nevojat e përdoruesve, dhe nëse jo, cila duhet të jetë ndërhyrja e përshtatshme rregullatore në këtë drejtim, nëse ka nevojë për dicka të tillë.

3.1 Aksesit dhe Shërbimi Telefonik nga Vendndodhje Fikse

Zhvillimi i sektorit në Shqipëri ka qënë disi i ndryshëm nga situata në vendet e BE-15 në vitin 2002, kur KE miratoi Direktivën e Shërbimit Universal. Sic është diskutuar në dokumentin e konsultimit publik, duke pasur parasysh dendësinë celulare/fikse dhe dinamikën e mbulimit, disa vende të BE-12 dhe CPC kanë vendosur që shërbimet fikse të ofruara nga rrjetet celulare plotësojnë kriteret për këtë element të shërbimit universal. Një shërbim i ngjashëm është aktualisht i diponueshem në Shqipëri (AMC Fiks) dhe AKEP ka arritur në përfundimin se këto shërbime janë pjesë e tregjeve përkatëse me pakicë të aksesit/thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse. Një shërbim i tillë përdor një aparat telefonik fiks të pajisur me kartë GSM dhe me numër gjeografik fiks dhe mund të përfitohet kudo ku ka mbulim me rrjet GSM të AMC (99.8% e popullsisë). Rrjetit GSM i AMC në kombinim me rrjetin e Altelecom dhe operatoreve të tjerë fiks, mbulon rreth 99,8% të popullsisë. Ky mbulim popullsie tregon se ky element i shërbimit universal aktualisht është shumë afër disponueshmerise universale në Shqipëri. Pra sipas këtij vlerësimi, rezulton se tregu aktualisht plotëson nevojat e përdoruesve fundore në lidhje me disponueshmërinë e këtij elementi të shërbimit universal. Më tej, analiza e kryer në dokumentin e konsultuar tregon se shërbimi telefonik fiks në përgjithësi, dhe shërbimi i Altelecom dhe AMC Fix në mënyrë specifike, janë të disponueshme me çmime të përballueshme, për kushtet kombëtare në Shqipëri - prandaj, nuk ka nevojë që aktualisht në këtë element të Shërbimit Universal të përfshihet një tarifë (paketë tarifore) sociale. Si përfundim rezulton se Shqipëria plotëson në masë të konsiderueshme detyrimin e SHU që ky element "të jete i diponueshem për të gjithë përdoruesit kudo në territorin e Shqipërisë, me një çmim të përballueshem".

Nga analiza rezulton se mund të ketë rreth 0.2% të popullsisë që aktualisht nuk ka akses në këtë element të SHU. Siç është përcaktuar në dokumentin e konsultuar, kjo përqindje ka qënë në rënie gjatë viteve si rezultat i hyrjeve të reja në treg dhe konkurrencës dhe pritshmerite jane që kjo prirje të vazhdojë. Nga një perspektivë e tillë largpamëse, AKEP nuk e konsideron si proporcionale caktimin e këtij elementi të SHU në këtë kohë dhe AKEP do të rishikoje situatën pas tre viteve – d.m.th. në vitin 2016.

AKEP arrin në përfundimin se tregu plotëson në masë të konsiderueshme nevojat e përdoruesve për këtë element të detyrimit të SHU dhe prandaj Shqipëria plotëson në masë të konsiderueshme detyrimin e DSHU që aksesit dhe shërbimi nga vendndodhje fikse "të jete i diponueshem për të gjithë përdoruesit kudo në territorin e vendit, me një çmim të përballueshem"

Në këtë mënyrë, AKEP gjykon se aktualisht nuk ka nevojë të përcaktojë këtë element të SHU duke përcaktuar ofruar të Shërbimit Universal. AKEP do të koordinojë/inkurajojë një ose disa operatorë të ofrojnë akses në vendndodhje specifike gjeografike që nuk kanë mbulim me shërbim telefonik, por jashtë skemës së SHU. AKEP do të rishikojë statusin e këtij elementi në vitin 2016.

3.2 Disponueshmëria e Numeratorit Telefonik dhe Rubrika e Informimit për Numrat

Aktualisht, Shqipëria nuk disponon numerator telefonik (CDir) apo shërbim të kërkimit të informacionit në numerator (DES). Altelecom ofron informacion për numrat e pajtimtarëve të tij, nderkohe as operatorët alternativë dhe as operatorët celularë nuk ofrojnë numerator apo shërbim për kërkimin e informacionit në numerator për pajtimtarët e tyre. Shqipëria aktualisht nuk e plotëson këtë element të detyrimit të SHU.

Duket se preferencat e konsumatorit në Shqipëri janë të tilla që shumë abonentë celularë nuk dëshirojnë të përfshijnë numrin e tyre celular në numerator, për shkak të shqetësimeve mbi mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë. Për shembull, AKEP ka dijëni nga operatorët, se shumica e klientëve me kontratë nuk zgjedhin opsionin për tu përfshirë në numerator gjatë regjistrimit të tyre. Formulari i regjistrimit për klientët me parapagesë në përgjithësi nuk e përfshin këtë opsion për t'u përfshirë në numeratorin e numrave celularë. Duke pasur parasysh se abonentët me parapagesë përbëjnë shumicën e të gjithë abonentëve celularë, kjo do të thotë se aktualisht vetëm një pjesë e vogël e numrave celularë mund të përfshihen në një numerator të plotë, nëse do të krijohej një i tillë. Një instrument kyç rregullator në këtë drejtim ka qenë dhënia e mundësisë abonentëve gjatë regjistrimit për të shprehur pëlqimin e tyre për të dhënat e tyre për t'u përfshirë në një numerator të plotë, me një klauzole "opt-in" ose "opt-out". Më tej, duket se nuk ka pasur asnjë kërkesë nga palët e treta në lidhje me informacionin për të formuluar një numerator të plotë apo kërkimi informacioni në numerator.

Bazuar në konsideratat e mësipërme, AKEP konsideron se në mungesë të ndërhyrjes rregullatore, nuk ka të ngjarë që në tre vitet e ardhshme ky shërbim të ofrohet nga ana e tregut në Shqipëri, në mënyrë që të përmbushë kriteret e DSHU.

AKEP konsideron si kritike që secili prej operatorëve të fillojë procesin e ndërtimit të bazës së të dhënave përkatëse të tyre, pra që secili pajtimtar të shprehë dëshirën e përfshirjes ose jo në numerator, dhe mbi këtë informacion të ndërtohet baza e të dhënave nga secili operator për abonentët e vet, e cila mund të përdoret më vonë nga vet operatorit ose nga palë të treta. Ky proces do të krijojë mundësi për arritje të një zgjidhjeje të ardhshme nga tregu për këtë element të SHU. Ndërkohë AKEP do të marrë në konsideratë sigurimin e kuadrit rregullator për krijimin e bazës së të dhënave nga secili operator dhe shkëmbimin e këtij lloji informacioni të lidhur me numeratorin midis operatorëve dhe palës që ofron këto shërbime. Zbatimi i dispozitave të tilla rregullatore mund të krijojë kushtet e tregut për një palë të tretë ose për një nga operatorët për të kërkuar informacion nga të gjithë operatorët për të formuluar një numerator të plotë apo shërbime të kërkimit të informacionit në numerator.

Në këtë mënyrë, nëse tregu do të ofronte zgjidhje për këtë shërbim nuk do ketë nevojë për ndërhyrje rregullatore për ofrimin e këtij shërbimi me skemën e SHU. Ky proces mund të kërkojë disa vite, por AKEP konsideron si kritike që të fillojë të ndërtojë themelet e krijimit të mundësive për tregun që të ofrojë këtë shërbim për të përmbushur këtë detyrim të DSHU në të ardhmen. Gjithashtu ky proces është i rëndësishëm, pasi ka mundësi që Shqipëria është duke humbur një mundësi të rëndësishme tregtare për shkak se ofrimi nga tregu i këtij shërbimi në vende të tjera ka rezultuar fitimprurës dhe i qëndrueshëm.

Në Shqipëri nuk ka numerator telefonik apo shërbim të kërkimit të informacionit në numëror dhe për këtë arsye Shqipëria nuk e plotëson detyrimin e SHU për këto elementë të SHU.

AKEP gjykon se nuk është e nevojshme që të caktojë këtë element të SHU në këtë kohë, sepse tregu nuk ka qenë i pajisur me mundësi të përshtatshme për të përmbushur nevojat e përdoruesve. Në vend të kësaj, AKEP do të ndër marrë masa rregullatore për të lehtësuar dhe për të promovuar një zgjidhje të tregut për këto elementë të SHU. AKEP do të rishikojë statusin e këtij elementi në vitin 2016.

3.3 Disponibiliteti i Telefonave Publikë me Pagesë

Densiteti i telefonave publike me pagesë ka qenë në rënie në të gjithë vendet e BE dhe vendet e rajonit (CPC). Gjatë pjesës së parë të dekadës së fundit, penetrimi i telefonave me pagesë pësoi një rritje të lehtë në Shqipëri; ndërsa në pjesën e dytë të dekadës, penetrimi ka qenë i qëndrueshëm. Densiteti i telefonave publike me pagesë në Shqipëri është edhe më i ulët se nivelet mesatare në BE dhe rajon. Rënia në densitetin e telefonave publike me pagesë në të gjithë kontinentin pasqyron një trend botëror të gjerë që reflekton përdorimin dhe nevojën e reduktuar për telefonat publike me pagesë për shkak të preferencave të konsumatorit për alternativa konkurruese, përfshirë mbulimin dhe aksesin global celular.

Për të pasqyruar këtë dinamike të tregut, disa vende të BE nuk e kanë përcaktuar disponueshmërinë e telefonave publike me pagesë si një element të detyrimeve të SHU, për shkak të arritjes në përfundim se përfshirja e këtij elementi nuk është efitente ose se kostot janë më të mëdha se përfitimet për shkak të përdorimit në rënie të tyre, dhe se një numër i mjaftueshëm i tyre po ofrohen nga tregu për të plotësuar kërkesën e arsyeshme të publikut, përfshirë rastet kur vetëm telefonat publikë me pagesë janë mjeti i arritshëm.

Pas një progresi të madh në disponueshmërinë e telefonave publikë me pagesë, përdorimi i tyre ka rënë kohët e fundit në Shqipëri. AKEP konsideron se është e mundshme që aktualisht tregu i plotëson ndjeshëm nevojat e përdoruesve për këtë element të SHU. Në këtë rast, nuk është e nevojshme që AKEP të caktojë këtë element të SHU. Nëse është e përshtatshme, AKEP do të koordinojë/inkurajojë një ose më shumë operatorë që të ofrojnë telefona publike me pagesë në vende të veçanta, por jashtë çdo skeme të detyrimeve të SHU. AKEP do të rishikojë statusin e këtij elementi të detyrimeve të SHU në vitin 2016.

3.4 Masat ekuivalente për përdoruesit me aftësi të kufizuar

Aktualisht, Qeveria Shqiptare parashikon një pagesë mujore prej 1000 lekë për përdoruesit me aftësi të kufizuara për të ndihmuar në financimin e pagesës së shërbimeve të telekomunikacionit. Bazuar në paketa të veçanta që janë vënë në dispozicion nga Albtelecom, një subvencion i tillë pagesë nga Qeveria Shqiptare lejon që përdorues të tillë me aftësi të kufizuara të blejnë një paketë të kombinuar të telefonisë dhe broadband që përfshin përdorim në masë të konsiderueshme të këtyre shërbimeve. Gjithashtu, disa operatorë fikse dhe mobile në baza komerciale dhe si pjesë e aktiviteteve të bazuara në komunitet, ofrojnë masa/pajisje

dhe skonto specifike për përdoruesit me aftësi të kufizuara. Të dyja këto iniciativa të QSH dhe sektorit privat janë të disponueshme në të gjithë territorin kombëtar.

Shteti ofron subvencion mujor prej 1000 Lek për përdorues me aftësi të kufizuara dhe ka disa masa të ofruara nga tregu për këta përdorues. AKEP konsideron se është e mundshme që subvencioni mujor i QSH në kombinim me iniciativat e sektorit privat aktualisht plotësojnë në masë të ndjeshme nevojat e përdoruesve për këtë element të SHU.

Në këtë rast, nuk është e nevojshme që AKEP të caktojë këtë element të SHU. Megjithatë edhe në rast se subvencioni i QSH nuk përmbush të gjitha nevojat e përdoruesve (rast pak i mundshëm), AKEP gjykon se nuk është e nevojshme të përcaktojë këtë element të SHU, pasi një përcaktim i tillë nuk do të ishte proporcional ose eficient për shkak so do të dublikonte politikën e QSH dhe do të pengonte/shmangte iniciativa private. Nëse është e përshtatshme, AKEP do të koordinojë/inkurajojë një ose më shumë operatorë që të ofrojnë masa specifike për përdoruesit me aftësi të kufizuara, jashtë çdo skeme të detyrimeve të SHU. AKEP do të rishikojë statusin e këtij elementi të detyrimeve të SHU në vitin 2016.

4 Plani Kuadër 2013-2016 për SHU

Duke marrë në konsideratë diskutimin e mësipërm si dhe dokumentin e konsultimit publik, përfshirë komentet e palëve të interesuara, AKEP gjykon që për periudhën 2013-2016 të zbatojë Planin Kuadër të mëposhtëm për Shërbimin Universal:

Periudhë afatshurtër (0-12 muaj)

1. AKEP të mos përcaktojë ndonjë element të detyrimeve të SHU ose ofrues të SHU, si dhe masa të tjera të lidhura me përcaktimin e Ofruesit/Ofruesve të SHU si kërkesa për kompensim, mekanizmi i financimit sektorial nëpërmjet mbledhjes së kontributeveve operatorit (FSHU).
2. AKEP të punojë për hartimin dhe përgatiten për konsultim publik të masave rregullatore për të promovuar zgjidhjet nga ana e tregut për numërorin telefonik dhe shërbimet e kërkimit të informacionit për numrat, duke përfshirë krijimin e bazës së të dhënave të secilit operator për pajimtarët e vet dhe për akses dhe shkëmbim të këtij informacioni me palë të treta.
3. AKEP të koordinojë/inkurajojë një ose disa operatore të ofrojnë akses në vendndodhje specifike gjeografike ku nuk ka mbulim me sinjal telefonik, jashtë skemes së SHU
4. Të punohet për hartimin dhe përgatiten për konsultim publik të rregulloreve dhe akteve të tjera nën-ligjore për SHU, të cituara në Ligjin 9918. Këto rregullore/akte të SHU do të plotësojnë dispozitat përkatëse të Ligjit 9918, të amenduar, në mënyrë për të siguruar më shumë detaje dhe specifikime, duke përfshirë në lidhje me kriteret, procedurat dhe metodologjinë, çështjet administrative në rast të përcaktimit të ofruesve të SHU në të ardhmen.

Periudhë afat-mesme (13-24 muaj)

5. Të kryhet një analizë më e detajuar e masave për akses ekuivalent për përdoruesit me aftësi të kufizuara.

Periudhë afatgjatë (25-36 muaj)

6. Të kryhet rishikimi i statusit të detyrimeve dhe përcaktimeve të gjithë elementëve të SHU në vitin 2016.